



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Nr. Prot. 02 / 3182 Datë: 16. 12. 2024

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1.3 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" të Gjilanit, si dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 01/23 të dt. 08.04.2020, Këshilli i Drejtues, në mbledhjen e dytë (II-) të mbajtur më 10.12.2024 nxjerr këtë:

**Rregullore
për përdorimin e telefonisë (fikse - mobile) në Universitetin Publik
"Kadri Zeka" në Gjilan**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton procedurat për përdorimin e rregullt dhe efikas të telefonave (fiks dhe mobil) në Universitetin Publik "Kadri Zeka" UKZ-së të Gjilanit, me qëllim të racionalizimit të shumës së shpenzimeve të telefonave për kryerjen e punëve dhe detyrave në kuadër të përgjegjësisë të zyrtarëve publik të përcaktuar në këtë Rregullore.

**Neni 2
E drejta për mbushje të telefonit mobil**

Të drejtë për mbushje të telefonave mobil kanë:

- ✓ Rektori
- ✓ Prorektorët
- ✓ Sekretari i përgjithshëm,
- ✓ Dekanët e njësive akademike,
- ✓ Prodekanët e njësive akademike,
- ✓ Drejtorët e departamenteve
- ✓ Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozita e barasvlershme
- ✓ Nëpunësit e punësuar në zyrën e Rektori
- ✓ Nëpunësit e punësuarit në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm

Neni 3

Barasvlershëm-ia e shpenzimeve për telefonin (fikse dhe mobile) të pozitave sipas vendimit të Qeverisë në Republikën e Kosovës nr.01/23. Dt. 08.04.2020 dhe organogramit e UKZ-së

Barasvlershmëria e Pozitave në UKZ për shpenzimet e telefonisë (fikse dhe mobile), janë si në vijim:

Pozita sipas vendimit të Qeverise nr. 01 /23, dt. 08.04.2020	Pozita sipas organogramit në UKZ
Ministri	Rektori
Zv. Ministri	Prorektorët
Sekretarët e përgjithshëm të ministrive	Sekretari i përgjithshëm i UKZ,
Drejtorët ekzekutive të agjencive	Dekanët e njësive akademike,
Drejtorët e departamenteve	Prodekanët e njësive akademike,
Drejtorët e departamenteve	Drejtorët e departamenteve
Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozita e barasvlershëm	Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozita e barasvlershme
Nëpunësit e punësuar në zyrën e ministrit	Nëpunësit e punësuar në zyrën e Rektorit
Nëpunësit e punësuarit në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm	Nëpunësit e punësuarit në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm

Neni 4

Shpenzimet mujore për mbushje të telefonit mobil

Shpenzimet mujore për telefonat mobil janë:

Nr.	Emërtimet	Shuma në euro
1	Rektori	50.00 €
2	Prorektorët	40.00 €
3	Këshilltari i rektorit	30.00 €
4	Sekretari i Përgjithshëm	30.00 €
5	Dekanët e njësive akademike	30.00 €
6	Prodekanët	20.00 €
7	Drejtorët e departamentit	20.00 €
8	Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozitat e barasvlershme	20.00 €
9	Sekretarët e fakulteteve	20.00 €
10	Nëpunësit e punësuar në zyrën e Rektorit	20.00 €
11	Nëpunësit e punësuarit në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm	20.00 €
12	Kyçja në rrjetin mobil (rreth) stafi administrativ ¹	5.00 €

¹ Të drejtë për kyçje në rrjetin mobil në vlerë prej 5.00 euro kanë vetëm zyrtarët administrative në pikën 10 të Nenit 4, e të cilët nuk përfitojnë mbushje për telefona mobil pozita prej 1 – 11

Neni 5
Pajisja me kartelë SIM

Të drejtë për pajisje me kartelë SIM kanë: Rektori, Prorektorët dhe Sekretari i Përgjithshëm i UKZ-së në Gjilan.

Neni 6
E drejta për telefon fiks

Të drejtë për qasje në telefon fiks kanë të gjithë zyrtarët nga neni 2 i kësaj Rregulloreje, si dhe çdo zyrtar i Universitetit publik “Kadri Zeka” të Gjilanit, varësisht nga natyra e punës me miratim nga Sekretari i Përgjithshëm i UKZ.

Neni 7
Shpenzimet mujore për telefonat fiks

Shpenzimet mujore për telefonat fiks janë:

Nr.	Emërtimet	Shuma në euro
1.	Rektori	70.00 €
2.	Prorektorët	50.00 €
3.	Sekretari i përgjithshëm i UKZ-së	30.00 €
4.	Drejtorët e departamenteve	30.00 €
5.	Udhëheqësit e divizioneve si dhe pozitat e barasvlershme	15.00 €
6.	Të gjithë shërbyes publikë të tjerë në UKZ	10.00 €

Neni 8
Procedura e pajisjes me telefon fiks

Çdo zyrtar i UKZ-së, i cili ka nevojë zyrtare për telefon fiks, së pari duhet të bëjë kërkesë me shkrim të nënshkruar nga Drejtori i shërbimit përkatës dhe pastaj kërkesa duhet të miratohet nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit.

Neni 9
Instalimi dhe mirëmbajtja e telefonave fiks

1. Njësia e teknologjisë informative më tej (NJTI) është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrjetit telefonik fiks në UKZ.
2. Instalimi i rrjetit telefonik fiks brenda lokaleve të Universitetit mund të bëhet vetëm nga zyrtarët e NJTI apo nga pala kontraktuese nën mbikëqyrjen e NJTI.
3. Në rast të defektit në rrjetin e telefonisë fikse brenda objektit të Universitetit, zyrtari është i obliguar të lajmëroi NJTI.

Neni 10
Raporti mujor i shpenzimeve për telefona fiks

1. Përgjegjësit e ngarkuar me telefon fiks në Universitetin publikë “Kadri Zeka” janë të obliguar që të dorëzojnë raportin mujor të shpenzimeve të telefonisë fikse tek ZKA më së largu deri më 10 të muajit vijues.
2. ZKA bazuar në raportet e pranuar harton raportin përfundimtar për shpenzimet e telefonisë fikse dhe të njëjtin e dorëzon në zyrën e financave në Universitet.

Neni 11
Përgjegjësia për shfrytëzimin e telefonit

1. Telefoni zyrtar i Universitetit përdoret për kryerjen e punëve dhe detyrave zyrtare dhe përdoruesi i tij duhet ta shfrytëzoj me përgjegjësi.
2. Telefoni zyrtar i Universitetit nuk mund të përdoret për biseda private.
3. Të gjitha shpenzimet që kalojnë shumën e përcaktuar me këtë Rregullore do të mbulohen nga zyrtari i cili ka tejkaluar shumën e përcaktuar.

Neni 12
Përgjegjësia për zbatimin e Rregullores

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje janë të gjithë të punësuarit në Universitetin Publikë “Kadri Zeka”, Gjilan.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UKZ-së



Dr. Techn. Ilir Gjinolli